# Arben Vrioni

GJYQTAR PRANË GJYKATËS SË APELIT DURRËS

**Deklaratat e analizuara:**

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017

Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite




Pasuria bruto nga fillimi I detyrës deri më datë 31.12.2017 është 3 herë.

+ 1,439,339 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

**Likuiditete në Bankë**




**Likuiditete në Cash**




**Pasuritë e Luajtshme**




**Pasuritë e Paluajtshme**




## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2017 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni | 16,173,087 | 22.92% |
| Të ardhura nga paga e bashkëshortes | 7,892,164 | 11.18% |
| Të ardhura nga puna e vajzës në SHBA | 19,484,328 | 27.61% |
| Fitimi nga shtiblerja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme | 5,143,800 | 7.29% |
| Të ardhura nga trashëgimia | 4,100,000 | 5.81% |
| Dhurata nga të afërmit | 300,000 | 0.43% |
| Të ardhura nga bursa e vajzës me studime në SHBA | 16,173,186 | 22.92% |
| Të ardhura nga interesat bankare | 1,295,869 | 1.84% |
| Total | 70,562,434 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**2 Me Probleme**

**12 Pa Probleme**

Subjekti Arben Vrioni rezulton me pasuri të pajustifikuar në vitin 2009 dhe 2010 përkatësisht në shumat 3,940,940 lekë dhe 1,926,981 lekë (pa përfshirë në këtë analizë shpenzimet e konsumit familjar vjetor).
Në vitin 2003, subjekti deklaron llogari bankare me vlerë 26 mijë dollarë, me burim të deklaruar si dhuratë nga nëna.
Në vitin 2009 është deklaruar një detyrim financiar në formë huamarrje në vleren 25,000 Pound nga baxhanaku që jeton në SHBA, pa interes dhe pa afat të përcaktuar shlyerje. Kjo vlerë është derdhur për llogari të vajzës, për studime në Uells. Në të njëjtin vit subjekti deklaron shlyerjen e shumës prej 21,000 pound për shpenzime shkollimi për vajzën, por nuk është e qartë nëse llogaria bankare e vajzës është përdorur për të mbuluar këto shpenzime apo jo.
Në vitin 2009, subjekti ka deklaruar depozitë dhe kursime cash gjithsej 1,300,000 lekë me burim nga kursimet e vitit 2008 dhe 2009, pa përcaktuar shumat e kursyera gjatë secilit vit.